



www.italy-ontheroad.it

PRIORITY



**Dhënia e së drejtës (ose një mirë e radhës).
Së qarkullimit në rrugë.**

Përshëndetje, jam Namauel

Jam një zë miqësor do që të përpiqet tiju ndihmojë me ndonjë këshillë mbi qarkullimin rrugor (në territorin italian).

Ju drejtohem djemve ose vajsare që dëshirojnë të zbulojnë botën vetëm mbi automjetin e tij.

Ju drejtohem gjithashtu të huajve që vinë në Itali nga vende të ndryshme të botës për ti këshilluar ose informuar mbi qarkullimin rrugor/italian në disa rregulla mund të jetë i ndryshëm nga vendet nga të cilat ju vinë.

Do tju shoqëroj nga pas pa u dukur me disa këshilla si më poshtë:

Udhëtim të mbarë 😊

Namauel

MOs respektimi i rregullave të dhënies të së drejtës (ose radhës, preçedencës) në qarkullim rrugor, ose kryerja e saj në mënyrë jo korrekte nga hutimi ose gabimi, janë shkak kryesor i aksidenteve rrugore.

Të gjithë përdoruesit e automjeteve duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë sinjaleve rrugore.

Në Itali çdo automjet dhe jo, qarkullon në të djathë të rrugës korsa në të majtë përdoret vetëm për parakalim, mund të qarkullohet paralelisht në qoftë se sinjalet e lejojnë këtë.

Kur ecim me biçikletë duhet të përdorim patjetër korsinë e biçikletave në qoftë se ajo ekziston.

Kur jemi duke ecur në këmbë ose duke vrapuar duhet të qëndrojmë në anë të majtë të rrugës në mënyrë që të shohin automjetet që vijnë përballë.





U jepet gjithmonë e drejta (ose radha, preçedencia) mjeteve të ndihmës së shpejtë si (ambulanca, policia, zjarrfiksave, etj), të cilat janë të dukshëm sepse janë të paisur me një dispozitiv që lëshon një dritë blu dhe kanë sirenën (zhurmëbërse).



		
118 Autoambulancë	115 Zjarrfiksa	112- 113 – Policia. Ruajtësit e rendit

Në bazë të rëndësisë ekziton një hierarki në sinjalet rrugore.

- 1) sinjalet e dhëna nga policia rrugore vlejné të parat;
- 2) Më pas vinë semaforët;
- 3) sinjalet vertikale të yëna në anë të ndryshme të rrugës;
- 4) sinjalet horizontale të shkruajtura mbi rrugë;
- 5) Rruga pa sinjale, këtu vlen rregulla e dhënie së të drejtës (radhës ose preçedencës) të automjeteve që vinë nga ana e djathtë.

				PA SINJALE: <u>E drejta nga e djathta</u>
Policia rrugore	Semafori	Sinjalet vertikale	Sinjalet horizontale	E drejta nga e djathta
1	2	3	4	5


Duhet të vlerësojmë drejtë çdo situatë si dhe të njohim mirë sinjalet vertikale dhe horizontale për të shmangur të papriturat në rrugë.


Vëmëndje e veçantë ndaj fëmijëve si dhe shumë respekt ndaj invalidëve dhe të moshuarve. Çdo gabim dhe ai më ë vogël mund të shkaktoj një aksident. Kujdes mos pengo atë që ka të drejtën e qarkullimit, ul shpejtësinë dhe ndalo në çdo kryqëzim. Mos respektimi i rregullave të së drejtës (radhës ose preçedencës) në qarkullim ose aplikimi jo korrekt i saj është shkak i shpeshtë i aksidenteve në rrugë. Kur jam mbi një mjet pa motor, si për shembull biçikleta, vlen rregulla e së drejtës (radhës ose preçedencës) si për mjetet me motor (autoveturat etj).

Saktësoj që: 1) Në rastin e parë e ka, kush ka shigjetën jeshile.

2) Në rastin e dytë kalon kush ka shigjetën e kuqe.


Disa lloje kryqëzimesh).





FUTJA NË QARKULLIM Kur futeni në qarkullim nga një zonë private si oborri i një shtëpie, duhet ti japësh të drejtën (e radhës ose preçedencës) këmbësorve që qarkullojnë mbi trotuar dhe më pas automjeteve ose mjeteve që ndodhen në rrugë. Në qoftë se del nga një vend ku të mungon pamja, duhet të ndalosh dhe në qoftë se është e pamundur të dalësh duhet të kërkosh ndihmën e ndokujt që të udhëheqi në manovrat që do të bësh. Kujdes të mos shkaktosh aksident kur del nga një parkexh, nga një fabrikë, nga një zonë shërbimesh, nga një mekanik nga një rrugë fshati, nga një shkollë etj.

E DREJTA NGA E DJATHHTA (Radha ose preçedencia). Kur duam të kthehemi nga ana e majtë duhet ti japim të drejtën gjithmonë mjeteve që qarkullojnë nga ana e kundërt. Kur dy trajektoret kryqezohen vlen rregulli i së drejtës (radhës ose preçedencës) nga e djathta. Duhet të sinjalizosh me dorë çdo ndryshim drejtimi kur jemi në bicikletë për ti bërë të kuptojnë të tjerët që qarkullojnë në rrugë qëllimet e tua (ose të ndezim sinjalizuesit e drejtimit).



U! shpejtësinë në afërsi të vendkalimeve për këmbësorë dhe jepi të drejtën kur kalojnë në kalimin e këmbësorve ose kur presin për ta kaluar atë.

Kujdes këmbësorët




Rrezik kalimkëmbësori



Tregues kalim këmbësori

Kur automjetet para teje ndalojnë nuk duhet të futesh në kryqzim me këmbësorët sepse mund të bllokosh qarkullimin e tyre.



Duhet ti japim të drejtën e (preçedencës) këmbësorëve që presin më të majtë e në të djathtë për të kaluar në një vend kalimi për këmbësorët. Kini kujdes gjithmonë të mos ndaloni mbi një vendkalim për këmbësorët por ndaloni vetëm përpara. Në mungesë të vend kalimit për këmbësorët n. q. se këmbësori dëshiron të kaloj rrugën jeni të detyruar të ndaloni dhe ta lëni këmbësorin të kalojë.




Rrezik fëmijët




Në zona shumë të banuara (lagje) limiti i shpejtësisë është 30 km / h.

Kujtohu të keni shumë KUJDES.

Këmbësorët e verbër kanë një shkop të bardhë kurse shurdhverbën, shkopiështë bardhë-kuq.




Iepni gjithmonë të drejtë (rradhë- preçedencë). Jepuni.




Kur afroheni në ndalesat e autobuzit ose TRAM keni kujdes personat që hypin e zbresin shpesh herë me shpejtësi nga këto mjete, gjithashtu kujdes fëmijët që mund të hypin e zbresin duke Vrapuar nga këto mjete.



NDALESA TRAM



N.q. se qarkullon në një korsi anash një korsi rezervuar për autobuzat përpara se të ktheheni në anën e djathtë duhet ti japim të drejtën (rradhën ose preçedencën). Para se të kthehesh përdor dorën (kur je me biçikletë) dhe shigjetën treguese të drejtimit (kur je në makinë). Kur autobuzi ka ndaluar në ndalesën e tij mos parakalo qëndro pas tij sepse papritmas mund të kalojnë rrugën fëmijë ose këmbësorë paparë dhe duke vrapuar. Kujdes të veçantë kushtojuni mjeteve me shkrimin SCUOLA BUS në afërsi të shkollave



Përdorimi i korsive



BUS shkolle




Ndalesë autobuzi




Rrezik vend kalimi për TRAM


Tram kanë gjithmanë të drejtë kalimi edhe ndaj këmbësorëve. Edhe n.q. se jeni në drejtim të duhur kur përballeni me një TRAM duhet ti lëroni rrugën, sepse TRAM ka një lëvizje të detyruar mbi binar.



Kalim hekurudhor pa mbrojtje



Në kalimet hekurudhore pa mbrojtje do të gjejme shtylla para lajmëruese me kryqin e SHEN ANDREAS shpesh nuk kanë drita lajmëruese (kuqe që ndizen e fiken) ndalo dhe ki kujdes.



kalim në nivel me pengesa




Panele distance (ose largësie) të gjitha kalimet e nivelit

Të gjithë kalimet hekurudhore janë të paralajmëruar me panele vertikale që tregojnë distancën nga kryqëzimi hekurudhor. Duhet të ndalosh sapo të shohesh dritat e kuqe të ndizen në mënyrë të alternuar dhe të shoqëruara me zhurmën e një zileje të fuqishme. Kalo kryqëzimin hekurudhor vetëm kur pengesat mbi binar të jenë ngritur dhe dritat e kuqe të jenë fikur.



E drejta (radha ose preçedenca) nga e djathta.

N.q. se ndodhesh para një kryqëzimi pa sinjale vertikale ose horizontale, kujtohu që vlen rregulli i së drejtës (preçedencës) nga e djathta. Ndalo dhe jepi të drejtën (preçedencës) e radhës njëteve që vinë pse janë të djathtë e juaj.




STOP NDAL


Detyrim për të ndaluar. Përpara shiriti të bardhë të shkruar mbi rrugë dhe jepi të drejtën (preçedencës) e radhës mjeteve të tjera.



Jepi të drejtën e radhës (preçedencës).

Duhet ti japësh të drejtën e radhës (preçedencës) edhe një mjëti që vjen nga e djathta e jote edhe pse është në një rrugë pa të drejtën e radhës (preçedencës). Përpara kalon ai, pas tij vjen ti, sepse ai vjen nga e djathta jote.





Kujtoni që me sinjalin e dhënies së drëjtës (preçedencës) duhet të ndaosh përpara yizës së pritjes (trekëndëshat) dhe duhet ti jepni përparësi të gjithë mijeteve që kabjnë në rrugë.



Jepni të drejtën e radhës (preçedencës)



Zonë me qarkullim të detyruar


Nq se ndodheni në një rrotullim rrugor (unazë) me sinjalet e mësipërme, duhet të ngadalsosh dhe të japësh preçedencën mjeteve që qarkullojnë brenda në rrotullim (unazë).




Kryqëzim me të drejtën e radhës (preçedencës)



E drejta e radhes (preçedencës)



Panele tregues të rrugës kryesore.



Duhet ti japësh preçedencën mjeteve që qarkullojnë në rrugën kryesore ose që duan të ndërrojnë drejtim. Vlen edhe me sinjalin e shkruajtur STOP (NDAL),




Kur je në një rrugë kryesore edhe pse ndërron drejtim, ju keni të drejtën e preçedencës.



Kujtoni gjithmonë të tregoni ndryshimin e drejtimit duke vënë shigjetat e tregimit (indikacionit) ose dorën kur jeni në biçikletë.


Kur je në një rrugë kryesore ke preçedencën me mjetet që vijnë nga rrugë të dyta.



Me sinjalin **FUND** i rrugës kryesore (mbaron e drejta e preçedencës) duhet tju japësh preçedencën mjeteve që vijnë nga e djathta.



Me dritën e kuqe duhet të ndalosh, me jeshilen rinisesh. Me të verdhën ndal, mund të kalosh vetëm nqs je mbi shiritin e **STOP** (**NDAL**). Kur ktheheni nga e majta ose nga e djathta me dritën jeshile kujtohu që edhe këmbësorët që kalojnë mbi vendkalimin e tyre kanë dritën jeshile si dhe të drejtën e preçedencës.



Semafor




Shigjeta drejtimi



Semafor këmbësorësh




Semafor për biçikleta



Semafor për autobuza dhe Tram.




Amsterdam
Semafor me Shën Valentinon.



Me shigjetën jeshile qarkullo në drejtimin e treguar, por:



Nqs ktheheni nga e djathta me shigjetën jeshile dhe me, ngjyrën e verdhë që ndizet dhe fiket kini kujdes ti jepni preçedencën.



Nqs ndizet sinjali me shigjetën jeshile drejte dhe nga e majta si dhe drita e verdhë që ndizet dhe fiket, dukeu kthyer nga e majta duhet ti jipni preçedencën mjeteve që vijnë nga ana e kundërt e rugës si dhe këmbësorve që kaljnë në vendkalimin e tyre.

Kuitohu që: me dritën e verdhë që vjen pas jeshiles duhet të ndaloni përpara se të hyni në kryqëzim.



Kur qarkulloni me biçikletë kushtoni vëmendjen sinjalet e ndriçuarra me drita për çiklistët.



Kjo gjë vlen dhe për këmbësorët.

Kujtohuni: kur ndizet drita e verdhë duhet kujdes sepse semaforët mund të jenë fikur, dhe me këtë duhet ose të ndalojmë ose ti japim preçedencën vendkalimeve për këmbësorë (ose biçikleta).



Kujdes kantiere pune



Këtu punohet (ka rreziqe).



E drejta e radhës (ose preçedencës) në rrugë vetën një kalim të alternuar me anën e kundërt. Këtë e gjejmë zakonisht në ngushtimet e rrugës për motive pune.



Jipni të drejtën e kalimit (preçedencës) në rrugë vetën një kalim me një korsi të alternuar në mënyrë reciproke, Edhe këtë sinjal e gjejmë në ngushtim rruge nga dy korsi të një për motiv pune.



Me këtë tabelë ose sinjal duhet të ndalojmë dhe ti japim të drejtën e radhës (preçedencës) nga ana e kundërt e rrugës.


Mos harro se në qoftë se gjen një pengesë ose ju bie ngarkesa në korsinë tuaj duhet ti jipni preçedencë ose radhën mjeteve që vinë nga ana e kundërt. Nqse qarkulloni në rrugë të ngushta malore, ai që zbret i jep gjithmonë preçedencë atij që ngjitet duke u spostuar në ndonjë shesh ndalimi ose duke qëndruar sa më anash korsisë ku ai ndodhet. Nqs mjete që ngjitet ka një shesh ndalimi në rrugë të ngushta mali duhet ta përdorë atë. Nqs s'mundet duhet të kryej manovra nga prapa. Kur jemi në rrugë të ngushta malore preçedencën e kanë mjetet mbi 3,5 t se ata nën 3,5 t. Autobuzat kanë preçedencë mbi kamionët edhe pse me masë më të madhe tonazhi. Kurse kur kemi dy mjete të të njëjtit tip, ai që është në ngjitje duhet të kryej manovrën e ecjes prapa. Por nqs mjete i rëndë që zbret është në pozicion të favorshëm (afër një shesh ndalimi) për ta bërë i takon atij, më mirë të themi don mirkuptim sipas rrethanave.



Rrugë (korsi) për biçikleta

Kur kthehemi majtas apo djathtas ti japim gjithmonë të drejtën e preçedencës (radhës) biçikletave që qarkullojnë në një rrugë apo korsi të rezervuar për to.

Kjo e drejtë u jipet gjithashtu kur dalim nga një rrugë e dytë jo kryesore (oborr, rrugë fshati etj).




Fundi të drejtës së qarkullimit me biçikletë

Kur dalim nga rruga ose korsia për biçikletat për tu futur në një rrugë tjetër duhet tu japim të drejtën e preçedencës mjeteve që qarkullojnë në të. Në fund të rrugës ose korsisë së biçikletave gjënden (jo gjithmonë) tabela me shkrimin "Fundi i rrugës ose korsisë së biçikletave".

Disa rregulla të përgjithshme.

Kujto gjithmonë se kush qarkullon në një rrugë me më shumë se sa një korsi paralele për të ndërruar korsi duhet kujdes për të mos vënë në rezik mjeteve e tjera që qarkullojnë në korsinë që duam të futemi duke i dhënë gjithmonë të drejtën e preçedencës (së qarkullimit).



Kanë të drejtën e preçedencës kush qarkullon në korsinë e vet: mos harroni që kush ndërron korsi duhet ti japi të drejtën e radhës (preçedencës).



Nqs udhëtoni në një rrugë me dy korsi dhe jeni tek ajo në të majtë dhe kërkon të futeni në korsinë e djathtë duhet ti jipni të drejtën e preçedencës mjeteve që qarkullojnë në atë korsi.



Nqs don të dalësh nga korsia që jeni (psh nqs ka një pengesë), duhet ti jipni të drejtën e preçedencës mjeteve që ndodhen në të.

Në rast se kemi shumë trafik në një kryqëzim pa semafor duhet në radhë të parë mirëkuptim ose “sistemin e menteshës”, që nënkupton kalimin e mjeteve herë nga një anë e pastaj nga tjetra, majtos apo djathtas qoftë mjete.



Gjithashtu nuk mund të bllokosh kryqëzimin edhe me semafor jeshil nqs nuk keni kohë për ta lëruar atë.

AUTOSTRADA



Kur futeni në autostradë duhet ti jipni të drejtën e preçedencës mjeteve që qarkullojnë në të.

Përshtat shpejtësinë e mjetit tënd në “korsinë e përshpejtimit” për tu futur në autostradë në mënyrën më të përshtatshme për të mos krijuar rrezik aksidenti.



Kur qarkulloni në autostradë keni ju të drejtën e preçedencës me mjetet e tjera që kërkojnë të futen në të.

Hyrja mund të jetë e paralajmëruar nga tabela me sinjalin e mësipërm me këtë shkrim “Hyrje e mjeteve nga e djathta”.

Asnjëherë mos harroni të:
zvogëlioni (ulni) shpejtësinë, kujdes, kujdes dhe vëmendje së bashku.

Rrugë të mbarë 😊

Data: 15 Nëntor (novembre) 2009

Riprodhim i pranuar me dëshirën dhe lejen e burimit e materialit të mësipërm.

Thanks to:
Mimoza Blea, Dritan Blea.